

*Strategjia*  
E KOMUNËS SHË  
DIBËRËS PËR  
BASHKËPUNIM ME  
SEKTORIN CIVIL  
DHE ZHVILLIMI I  
TIJ I PËRHERSHËM

2012-2015



KOMUNA  
DIBËR



# Strategjia

## E KOMUNËS SHË DIBRËS PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN CIVIL DHE ZHVILLIMI I TIJ I PËRHERSHËM 2012-2015

Dialogu qytetar në nivel lokal

Projekti është i financuar nga Unioni Evropian

“Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.”



QENDRA  
MAQEDONASE  
PËR BASHKËPUNIM  
NDËRKOMBËTAR

Projektin e realizon Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar



# Përmbajtja

## I HYRJE

1.1. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë .....	2
1.2. Metodologjia .....	2
1.3. Parimet .....	3
1.4. Përfshirja e sektorit civil: grupi qëllimor .....	5
1.5. Komiza kohore .....	5

## II SEKTORI CIVIL NË DIBËR 6

## III QËLLIMET SPECIFIKE 8

3.1. Mekanizëm i vendosur i bashkëpunimit mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare dhe grupeve joformale të qytetarëve .....	9
3.2. Rritja e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale.....	11
3.3. Zhvillimi i partneriteteve strategjike mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare.....	12
3.4. Mekanizëm i vendosur për mbështetje (financiare) të iniciativave të përbashkëta të komunës dhe OQ .....	13
3.5. Avancimi i rolit të OQ dhe vullnetarizmi në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës .....	14

## IV ZBATIMI, PËRCJELLJA DHE REVIZIONI 16

## SHTOJCA 1. PLANI AKSIONAR 18

I HYRJE

Shoqëria civile në procesin e vendimmarrjes është ka rëndësi të madhe për çdo shoqëri, e cila deklarohet si demokratike, veçanërisht është e rëndësishme për demokracitë e reja. Krijimi i mekanizmave institucionale për bashkëpunim të qytetarëve dhe organeve dhe trupave shtetërore, veçanërisht në nivel lokal, në procesin e krijimit të politikave dhe akteve tjera është baza e demokracisë participative. Komuna e Dibrës në tërësi e njëh rëndësinë dhe rolin e sektori civil në zhvillimin e proceseve demokratike në komunë dhe në përgjithësi në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës në bashkësi. Organizatat qytetare (OQ) në Dibër shumë herë gjatë periudhës së kaluar e kanë vërtetuar përkushtimin e tyre në plotësimin e nevojave të qytetarëve përmes aktiviteteve të shumta në fusha të ndryshme si: ndihma sociale dhe humanitare, manifestimet kulturore, ngjarjet sportive, mbështetja e arsimit, aksionet ekologjike, aftësimi i të rinjve, inkurajimi i grupeve të marginalizuara etj.

Duke u nisur nga këto fakte, Komuna e Dibrës vendosi ta avancojë bashkëpunimin me organizatat qytetare dhe të kontribuojë drejt zhvillimit të tyre të përhershëm, me qëllim të kontribuojë drejt iniciativave të shtuara qytetare dhe bashkësisë së zhvilluar lokale nga çdo aspekt.

Komuna e Dibrës edhe deri tani bashkëpunonte me sektorin civil, edhe pse nuk ka person të caktuar zyrtar me përkrahje të qartë të kompetencave për këtë bashkëpunim. Por, ky dokument strategjik dhe masat e parapara me atë duhet të paraqesin kornizë udhëheqëse për politikën e komunës drejt sektorit civil dhe drejt zhvillimit të aktivizimit qytetar. Miratimi i Strategjisë së Komunës së Dibrës për bashkëpunim me sektorin civil dhe zhvillimin e tij të përhershëm është kontribut i drejtpërdrejtë edhe drejt realizimit të njëres nga përcaktimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim me sektorin civil (2007-2011). Në të vërtetë, në qëllimin e shtatë të strategjisë nacionale është paraparë *“Përmes promovimit të qëllimeve dhe masave të strategjisë në nivel lokal, njësitë e vetëqeverisjes lokale do ta njohin rëndësinë e bashkëpunimit dhe zhvillimi të organizatave qytetare lokale dhe do të mund të miratojnë mekanizma të ngjashme për bashkëpunim dhe inkuadrim të organizatave qytetare në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta”*.

Procesi i përgatitjes së strategjisë është udhëhequr nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) si pjesë nga projekti “Dialogu qytetar në nivel lokal”, i zbatuar nga MCMS, ndërsa i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut (EIDHR).

Strategjia është miratuar më 27 dhjetor, në mbledhjen e 28 të Këshillit të Komunës së Dibrës.

# 1.1. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është forcimi i bashkëpunimit të komunës me sektorin civil dhe avancimi i bashkësisë përmes inkuadrimin aktiv të organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave të përbashkëta dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Strategjia paraqet kornizë udhëheqëse për politikën afatmesme të mbështetjes së zhvillimit të sektorit civil në Dibër. Komuna do të mbështetë organizatat qytetare me qëllim të forcimit të tyre, etablimin dhe njohjen nga bashkësia lokale, si forma themelore të shprehjes së shoqëruar të nevojave lokale. Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme në radhët e tyre që të sigurojë mekanizëm, i cili do ta jep mbështetjen e nevojshme të inkuadrimin të organizatave qytetare në identifikimin dhe në krijimin e politikave lokale, dhe me këtë drejtpërdrejt do të duhet të kontribuohet edhe ndaj zgjidhjeve më të qëndrueshme të bazuara në resurset lokale në çdo kuptim (njerëzore, materiale et.).

Komuna do të përpiqet që bashkëpunimin e deritanishëm të suksesshëm me organizatat qytetare ta shndërrojë në modele më të avancuara dhe më të qëndrueshme të partneritetit dhe dialogut, e para së gjithash për:

- ▶ Caktimin e personit përgjegjës dhe trupit koordinues për avancimin e bashkëpunimit me komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare dhe grupeve tjera të prekura të qytetarëve;
- ▶ Krijimin e kushteve për rritjen e ndikimit të organizatave qytetare dhe qytetarëve gjatë krijimit të politikave, të cilat janë të rëndësishme për bashkësinë lokale;
- ▶ Partneritete strategjike mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare të cilat kontribuojnë për arritjen e qëllimeve dhe prioritetëve me interes publik;
- ▶ Sistem transparent të mbështetjes financiare të organizatave qytetare nga ana e komunës;
- ▶ Mbështetja e organizatave qytetare në rolin e tyre të promovuesve të aktivizimit qytetar dhe të vullnetarizmit, në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.

Përkushtimi i Komunës së Dibrës që ta avancojë bashkëpunimin me organizatat qytetare është rezultat i mirënjohjes së deritanishme për kontributin e organizatave qytetare në promovimin e ideve përparimtare dhe vlerave me interes për të gjithë qytetarët.

## 1.2. Metodologjia

Strategjia është përgatitur në mënyrë konsultative me inkuadrimin e organizatave qytetare në periudhën prej shatori deri në nëntor të vitit 2011, në dy faza.



Në fazën e parë u promovua grupi punues për përgatitjen e konceptit të Strategjisë. Si mbështetje për udhëheqjen e procesit ishte përfaqësuesi i MCMS-së, ndërsa grupin punues e përbëjnë pesë anëtarë dhe atë: një përfaqësues i Këshillit të Komunës së Dibrës, dy përfaqësues nga administrata komunale dhe dy përfaqësues nga organizatat qytetare. Grupi punues mbajti tre punëtori njëditore, në të cilat u vendos struktura e Strategjisë dhe u përcaktuan qëllimi i përgjithshëm, parimet dhe propozim-aktivitetet. Me propozim-konceptin e përgatitur u rumbullakua faza e parë nga përgatitja e strategjisë.

Në fazën e dytë, propozim-koncepti i Strategjisë u diskutua në forumin e parë me një grup më të madh të organizatave dhe përfaqësuesve të Këshillit të Komunës së Dibrës. Vërejtjet e dhëna gjatë forumit për dokumentin e propozuar u shqyrtuan përsëri nga ana e grupit punues.

Krahas modelit të kombinuar të diskutimeve të fokusuar përmes grupit punues dhe konsultimeve më të gjera, identifikimi i nevojave të sektorit dhe aktivitetet prioritare gjithashtu u përcaktuan edhe përmes pyetësorëve të përgjigjur nga ana e organizatave.

Procesi i përgatitjes së Strategjisë përfundoi në punëtorinë konsultative dyditore të Këshillit programor të projektit “Dialogu qytetar në nivel lokal”, i cili është përbërë nga përfaqësues të tre pilot-komunave në projekt (Manastir, Dibër dhe Jegunovc), përfaqësues të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, përfaqësues nga Bashkësia e Njësieve të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) dhe përfaqësues të MCMS.

## 1.3. Parimet

### Subsidiariteti si themel i raportit të partneritetit

Komunikimi dhe inkuadrimi do të zhvillohet nga vetë fillimi deri në fund të një procesi të caktuar, gjegjësisht nga niveli më i ulët, nga qytetari dhe organizatat qytetare të cilat inkuadrohen në procesin e përgatitjes së këtij dokumenti strategjik, e deri te realizimi i tij aktual. Konceptet siç janë “forumet në bashkësi”, “inkuadrimi në procesin e vendimmarrjes së vetë qytetarëve”, “grupet qytetare”, “trupi qytetar” e kanë parasysh qytetarin në rend të parë.

### Shkëmbimi i deve dhe konsultimeve

Komuna do të krijojë klimë të komunikimit aktiv, ku komuna do ti dëgjojë të gjitha propozimet, ndërsa qytetari do të mund ti përcjellë qëndrimet dhe mendimet e veta.

Ky plan strategjik do të krijojë mekanizëm, me të cilin pushteti lokal do ti motivojë organizatat qytetare për pjesëmarrje aktive në mbledhjet e Këshillit të komunës, dhe atë përmes rregullores së Këshillit të komunës, përmes caktimit të njeriut/hallkë e komunës dhe organizatave qytetare, si dhe trupit të përzier për përcjelljen e qasjes strategjike.

## Transparenca

Në këtë dokument strategjik niset nga fakti se transparenca është një nga parimet kryesore të demokracisë. E njëjta paraqet masë parandaluese për shmangien e dukurive të mundshme të pakënaqësisë dhe pasojave tjera socio-politike. Mekanizmi i motivimit të organizatave qytetare të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të komunës nuk duhet ta garantojë vetëm cilësinë e vëzhguesve, por do të jetë më thelbësore dhe më e thellë, ndërsa në kuadër edhe të kufijve të parapara me ligj. Informimi për aktivitetet e sektorit publik do të jetë më i intensifikuar dhe i organizuar dhe i koordinuar më shpesh përmes kuadrit të trajnuar profesional dhe të rregullt, strukturë më efikase dhe thjeshtëzimi i qasjes përmes zgjidhjeve elektronike dhe të softuerit.

## Pavarësia

Komuna do ta udhëheqë procesin e krijimit të kushteve ku organizatat qytetare do të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes publike, në përsosjen e punës së sektorit publik, veçanërisht kur i njëjti tregon jo sinqeritet, profesionalizëm të pamjaftueshëm dhe vepron në mënyrë jo demokratike ndaj bashkësisë së vet. Ky parim bashkë me parimin e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit do të krijojë bazë ku sektori civil, mjaft i pavarur në qëndrimet e veta do të luajë rol të “pasqyrës” së sektorit publik, e jo në lojalitetin e pabazë ndaj të njëjtit.

## Mundësi të barabarta dhe jo diskriminimi

Respektimi i mundësive të barabarta dhe jo diskriminimi do të jenë udhëheqës në vendosjen e raporteve për besim dhe bashkëpunim të ndërsjellë dhe në të njëjtën kohë mes tjerash edhe reflektim i multikulturalizmit në komunën e Dibrës. Rëndësia e këtij parimi do të potencohet edhe me përgatitjen dhe miratimin e Rregullores për mundësi të barabarta dhe jo diskriminim.

## 1.4. Përfshirja e sektorit civil: grupi qëllimor

Komuna e Dibrës ka kuptim të gjerë për shoqërinë civile duke e pranuar definicionin se *“shoqëria civile është pjesë e hapësirës shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, që është krijuar nga ana e aksioneve individuale dhe kolektive, organizatave dhe institucioneve me qëllim të arritjes së interesave të përbashkëta”*.<sup>1</sup> Kjo nënkupton se sektori civil i përfshinë të gjitha format e shoqërimit të përcaktuar me Kushtetutën dhe ligjet, siç janë: shoqata dhe fondacione, sindikata, oda ekonomike, paritë politike, bashkësi fetare etj. Por për nevojat e kësaj strategjie është vendosur që të merren parasysh format organizative, të cilat i takojnë kuptimit më të ngushtë të sektorit civil, e këto janë organizatat e regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione.<sup>2</sup> Nevoja nga fokusimi i bashkëpunimit vetëm me shoqatat dhe fondacionet është për shkak të specifikave të tyre të formave themelore të shoqërimit, të cilat i shprehin interesat para së gjithash të qytetarëve dhe bashkësisë dhe i artikulojnë më së drejtpërdrejti. Kjo Strategji në titullin dhe përmbajtjen e saj i përdor termet organizata qytetare, sektori civil, shoqëria civile, të cilat e referojnë definicionin më të ngushtë dhe përdoren si sinonime për shoqatat dhe fondacionet.

Komuna e Dibrës, krahas formave formale të shoqërimit i përfshinë edhe grupet joformale të qytetarëve si grup qëllimor të kësaj Strategjie. Përvoja e deritanishme e pranimit të ideve dhe propozimeve nga qytetarët dhe grupeve të qytetarëve përmes kësaj Strategjie do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mënyrë më të organizuar.

Gjithashtu, duke e pasur parasysh qëllimin e përgjithshëm të kësaj strategjie, një pjesë e masave parashohin bashkëpunim dhe partneritet të përbashkët të pushtetit lokal dhe organizatave qytetare dhe me aktorët tjerë në shoqëri, gjegjësisht në bashkësi, siç janë bizneset lokale, shoqatat e punëdhënësve, sindikatat etj.

## 1.5. Korniza kohore

Korniza kohore për zbatimin e strategjisë është katër vjet, ndërsa e njëjta do të zbatohet në periudhën nga janari i vitit 2012 deri në dhjetor 2015.

<sup>1</sup> Definicioni është harmonizuar në Civikus – Indeksi i shoqërisë civile për Republikën e Maqedonisë, MCMS, 2011

<sup>2</sup> Gazeta zyrtare e RM, nr. 52/2010, Ligji për shoqata dhe fondacione

II SEKTORI  
CIVIL NË  
DIBËR

Përfundimisht me dhjetorin e vitit 2010 në Komunën e Dibrës janë regjistruar 85<sup>3</sup> shoqata dhe fondacione, derisa deri më 31 gusht 2011 janë reregjistruar vetëm një e treta, gjegjësisht 28 organizata<sup>4</sup>. Mesatarisht në Komunën e Dibrës ka nga 4,5 organizata të regjistruara në 1000 banorë, që është pak nën mesataren e definuar në nivel të gjithë vendit (5,6 organizata në 1000 banorë). Shoqatat sportive dhe sociale-humanitare janë më me numër (20% gjegjësisht 16%), pastaj vijojnë shoqatat të cilat veprojnë në fushën e kulturës (9%). Pjesa më e madhe, gjegjësisht 44% janë organizata të cilat në pajtim me klasifikimin e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë (RQM) numërohen në “organizata të tjera shoqërore, fondacione dhe shoqata të qytetarëve”. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2010 të organizatave të cilat e kanë dorëzuar llogarinë përfundimtare kap vlerën prej 14.813.880 denarë, derisa në sektor janë punësuar dhjetë persona.

Sipas sektorëve, organizatat në mënyrë dominuese më aktive janë në fushat që vijojnë dhe merren me këto aktivitete:

- 1) Shoqata sportive-rekreative: aktivitete për peshkim, manja me kajak, basketboll për të rinj, futboll (liga e dytë), karate (me mirënjohje ndërkombëtare, pingpong etj.);
- 2) Mundësi të barabarta: qendrat dhe shoqatat e grave, të drejtat e bashkësive më të vogla etnike;
- 3) Nevoja të kufizuara: grupe shëndetësore invalidore, invalidë të luftës etj.;
- 4) Zhvillimi i bashkësisë: disa shoqata aktive për zhvillimin e bashkësisë;
- 5) Trashëgimia, tradita kulturore: oda ekonomike, zejtaria, klubi i shkrimtarëve, shoqata për zhvillimin e identitetit kulturor dhe historik, shoqata teatrore etj.

Aktivitete të organizatave qytetare të cilat shpesh janë mbështetur edhe nga komuna, bëhen manifestime tradicionale për qytetin. Mes tyre janë: Festivali i teatrit shqiptar; Portik i poezisë (me karakter ndërkombëtar); Tume në futboll të vogël; Regata e kajakut në ujëra të qetë (ndërkombëtar); ndeshje të klubit futbollistik “Korab”; aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor në bashkëpunim me SHE “Deshat” etj. Organizatat qytetare luajtën rolë shumë të rëndësishëm edhe nga aspekti socio-humanitar, gjegjësisht ishin prijës në pranimin e refugjatëve nga Kosova në vitin 1999.

Organizatrat në Dibër ballafaqohen me probleme të ngjashme si edhe organizatat tjera në nivel të shtetit. Një pjesë e vogël e tyre kanë hapësirë të siguruar për punë, nuk kanë personel të rregullt të punësuar, nuk kanë burime të rregullta të financimit etj. Këto fakte shpeshherë i sjellin në pyetje edhe mbajtjen e manifestimeve të lartpërmendura të njohura dhe tradicionale.

Në Dibër karakteristike është edhe organizimi joformal i grupeve të njerëzve. Të njëjtit formohen për theksimin e problemeve dhe çështjeve të caktuara, dhe veprojnë deri në momentin e zgjidhjes së çështjes konkrete. Aplikimi i kësaj mënyre të organizuar të veprimit ka të bëjë me projektet nga infrastruktura lokale dhe shpesh karakterizohet me elementin e vetë kontributit (rugë lokale, ndriçimi rugor, trotualet, parqet, kanalizimi dhe ujësjellësi etj.).

---

3 Burim: RQM

4 Në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione organizatat kanë obligim të bëjnë harmonizimin e akteve të veta, gjegjësisht të ri-regjistrohen. Edhe pse Ligji nuk parasheh afat të fundit për ri-regjistrim, pritet që kjo e dhënë pas 16 muajve nga miratimi i Ligjit për numrin e organizatave të ri-regjistruara ta paraqesë përafërsisht numrin real e organizatave aktive.

# III QËLLIMET SPECIFIKE

Komuna e Dibrës ka për qëllim ta forcojë dhe avancojë bashkëpunimin me sektorin civil dhe të kontribuojë drejt avancimit të bashkësisë përmes inkuadrimit aktiv të organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave të përbashkëta dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke u angazhuar për këto aritje, Komuna e Dibrës kontribuon edhe drejt forcimit të sektorit civil në drejtim të promovimit të rolit të tij në plotësimin e rolit të pritur shoqëror që i takon sektorit.

Plotësimi i qëllimit të përgjithshëm të Strategjisë do të realizohet përmes pesë qëllimeve të ndërlidhura mes veti:

- ▶ Mekanizëm i vendosur i bashkëpunimit mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare dhe grupeve joformale/grupeve të qytetarëve;
- ▶ Rritja e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale;
- ▶ Zhvillimi i partneriteteve strategjike mes komunës dhe organizatave qytetare;
- ▶ Mekanizimi i vendosur për mbështetje (financiare) të projekteve të organizatave qytetare;
- ▶ Avancimi i rolit të organizatave qytetare dhe vullnetarizmit në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

## 3.1. Mekanizëm i vendosur i bashkëpunimit mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare dhe grupeve joformale të qytetarëve

Komuna e Dibrës ka për qëllim të vendos mekanizëm funksional për bashkëpunim mes komunës dhe organizatave qytetare, në mënyrë primare përmes caktimit të personit përgjegjës nga komuna dhe përmes formimit të Komitetit drejtues të përbërë nga përfaqësues të organizatave qytetare dhe pushtetit lokal. Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit dhe plotësimit të këtij qëllimi paraqet ekzistimi i bazës pa pagesë të dhënave të organizatave qytetare të regjistruara në Komunën e Dibrës. Kjo bazë do të jetë pjesë nga hapësira e ueb faqes së komunës ku në mënyrë të thjeshtë secili do të mund të ketë qasje dhe ti përdorë të dhënat e publikuara dhe rregullisht të azhuruara, me çka do të lehtësohet dhe pasurohet komunikimi jo vetëm mes komunave dhe organizatave qytetare, por edhe mes vetë organizatave qytetare dhe grupeve joformale të qytetarëve.

Që të arrihet ky qëllim komuna do të angazhohet për:

- 1) Caktimi i personit nga komuna me kompetenca të qarta për bashkëpunim me OQ;
- 2) Themelimi i Komitetit drejtues për përcjelljen e bashkëpunimit mes komunës dhe OQ dhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë (përfaqësues të OQ, pushteti lokal);
- 3) Sigurimi i hapësirës në ueb faqen e komunës për organizatat qytetare;
- 4) Forcimi i kapacitetit të personit përgjegjës për bashkëpunim me sektorin civil dhe të nëpunësve relevant nga administrata komunale.

Për arritjen e këtyre rezultateve komuna do të fillojë me definimin e përshkrimit të kompetencave për personit përgjegjës për bashkëpunim me organizatat qytetare, pas çka do të bëhet zgjedhja e tij. Komunikimi mes personit përgjegjës dhe organizatave qytetare do të zhvillohet përmes shkëmbimit të informatave, mbajtjes së mbledhjeve, përgatitja e raportimit dhe buletineve. Njohuritë dhe shkathësitë e personit të zgjedhur për bashkëpunim, si dhe nëpunësit relevant nga komuna do të vlerësohen dhe më vonë në mënyrë adekuate do të zhvillohen përmes trajnimeve, vizitave të studimit, shkëmbimit të përvojave, etj. Do të themelohet Komiteti drejtues, i cili do ta ndjekë bashkëpunimin mes komunës dhe organizatave qytetare, si dhe zbatimin e Strategjisë. Për themelimin e tij do të definojnë kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të komitetit, e pastaj edhe do të zgjedhen të njëjtë. Do të rekomandohet që përbërja e Komitetit drejtues ta përbëjnë përfaqësues dominues të organizatave qytetare, ndërsa numër më i vogël i nëpunësve nga administrata komunale dhe anëtarë të Këshillit të Komunës së Dibrës. Anëtarët e Komitetit rregullisht do të mbajnë mbledhje dhe do të përgatisin program vjetor për punën në pajtim me Strategjinë. Përcjellja e zbatimit të Strategjisë do të përmbahet në raportet vjetore, për të cilat përmes tjerash do të merren informata edhe nga fokus grupet, të përbëra nga anëtarë nga organizatat qytetare dhe pushtetit lokal. Bashkëpunimi mes organizatave dhe komunës do të thellohet përmes sigurimit të hapësirës së ueb faqes së komunës për organizatat qytetare. Në këtë hapësirë do të krijohet baza e të dhënave për organizatat qytetare, për çka të dhëna do të fitohen nga RQM, ndërsa do tu bëhet thirrje edhe organizatave që të regjistrohen në bazë. Do të furnizohet zgjidhje e softuerit për bazën e të dhënave, ndërsa pas vendosjes së të njëjtës do të angazhohet nëpunës përgjegjës për mirëmbajtjen e saj dhe azhurnimin e rregullt. Gjithashtu ueb faqja do të sigurojë hapësirë ku organizatat do të mund të informohen për aktivitetet e tyre, rezultatet, ngjarjet etj., si dhe hapësirë për raportet vjetore të organizatave, statutet e tyre etj.



## 3.2. Rritja e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale

Qasja participative e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale nënkupton nevojë nga rritja e numrit të organizatave qytetare dhe qytetarëve të cilët do të inkuadrohen në këto procese të pushtetit lokal. Komuna do të ndërmerrë të gjitha masat e domosdoshme që tu mundësojë organizatave qytetare dhe qytetarëve ti shprehin qëndrimet e tyre lidhur me politikat lokale dhe të njëjtat do të shqyrtohen në proceset e vendimmarrjes.

Që të arrihet ky qëllim, komuna do të angazhohet për:

- 1) Integrimi i parimeve të pjesëmarrjes në rregulloren e pushtetit lokal;
- 2) Motivimi i organizatave qytetare të inkuadrohen në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve strategjike në fusha të caktuara (mjedisi jetësor, çështjet sociale, kultura, sporti, të rinjtë, arsimi, zhvillimi ekonomik, etj.);
- 3) Përfaqësues të organizatave qytetare të marrin pjesë në trupat/komisionet punuese të pushtetit lokal;
- 4) Praktikizmi i modelit “Forumet në bashkësi” si mënyrë e inkuadrimit të OQ dhe qytetarëve në proceset e krijimit të politikave.

Për realizimin e këtyre rezultateve Komuna e Dibrës para së gjithash do ta ndryshojë dhe plotësojë Statutin e komunës me parimet për bashkëpunim aktiv me sektorin civil dhe përpunimin e rregullores për inkuadrim të sektorit civil në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale. Me qëllim që të promovohen organizatat qytetare për inkuadrimin në proceset e planifikimit dhe zbatimin e politikave lokale, Komuna e Dibrës do të përgatisë plan për inkuadrimin e tyre.

Plani do t’ju japë impuls fillestar në fushat me interes të tyre, që në mënyrë më aktive të angazhohen dhe të inkuadrojnë përfaqësues të tyre në trupat/komisionet punuese të pushtetit lokal, të cilët do të angazhohen për krijimin më të mirë të politikave lokale. Hapi i ardhshëm do të jetë formimi i grupit të përzier punues, i cili do ta përgatisë procedurën dhe kriteret për zgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare në trupat punuese të komunës. Përfaqësuesit e organizatave qytetare, në bazë të sistemit të vendosur për seleksionim, do të inkuadrohen në komisionet e pushtetit lokal, në pajtim me temat për diskutim të komisionit. Gjithashtu nxitet komunikimi i rregullt dhe konsultimet mes Komitetit drejtues për përcjelljen e zbatimit të strategjisë dhe Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive. Modeli i forumeve në bashkësi në Komunën e Dibrës si model themelor për inkuadrimin participativ në identifikimin e nevojave lokale do të praktikohet përmes organizimit të ngjarjeve të rregullta konsultative për

zgjehje të projekteve prioritare në të cilat do të inkuadrohet numër sa më i madh i qytetarëve dhe organizatave qytetare. Në këto ngjarje do të përcaktohen nevojat prioritare në komunë dhe me mjete nga buxheti komunal dhe donacionet tjera do të realizojë projekte, të cilat do të jenë përgjigje ndaj nevojave të identifikuara. Komuna e Dibrës përmes organizimit të forumeve në bashkësi do të kontribuojë drejt rritjes së pjesëmarrjes së organizatave qytetare dhe qytetarëve, potenciali i të cilëve për demokratizmin e proceseve të vendimmarrjes në pushtetin lokal akoma nuk është shfrytëzuar sa duhet.

### 3.3. Zhvillimi i partneriteteve strategjike mes Komunës së Dibrës dhe organizatave qytetare

Komuna e Dibrës ka për qëllim mes tjerash edhe ta ngrëjë bashkëpunimin me organizatat qytetare në nivel të partneritetit, veçanërisht gjatë ndërmarrjes së aksioneve të përbashkëta në fushat me interes për pushtetin lokal. Rëndësia nga zhvillimi i partneriteteve strategjike në thelb do të shqyrtohet pasi që të analizohen dhe fushat e veçanta specifike, ku pushteti lokalë mund të bashkëpunojë me organizatat qytetare, si dhe tu delegojë kompetencat e veta si praktikë e dobishme për palët e prekura nga aspekti i lehtësimit të funksionimit të vetëqeverisjes lokale, inkuadrim më të madh të organizatave qytetare dhe qytetarëve dhe shkëmbimi i ndërsjellë i informatave dhe të mësuarit.

Që të arrihet ky qëllim komuna do të angazhohet:

- 1) Ti analizojë dhe caktojë fushat specifike me interes për bashkësinë lokale për iniciimin e partneritetit me organizatat qytetare;
- 2) Vendos mekanizëm për koordinim gjatë financimit të mundshëm të aktiviteteve nga fushat e caktuara me interes për bashkësinë lokale;
- 3) Caktojë kriteret për delegimin e kompetencave nga ana e komunës te organizatat qytetare.

Analizimi i fushave specifike me interes për bashkësinë lokale do të realizohet me organizimin paraprak të procesit konsultativ të komunës me organizatat dhe caktimin e fushave, të cilat pastaj do të promovohen për shkak të realizimit të aksioneve dhe projekteve të përbashkëta me organizatat qytetare. Në përpjekjet e Komunës së Dibrës të vendos mekanizëm për koordinim kur janë në pyetje burimet e mundshme të financimit nga donatorë të tjerë (si IPA e BE etj.) do të organizohen ngjarje informative për thirrjet e hapura për financim, mbledhje të rregullta për partneritete të mundshme për aplikim të projekteve dhe mundësi për aplikacione të përbashkëta, nënshkrimin e memorandumeve për bashkëpunim etj. Gjithashtu thirrjet nga të gjithë donatorët

për financim të projekteve të cilat mund të zbatohen nga organizatat qytetare ose në partneritet mes komunës dhe organizatave qytetare do të shpallen në ueb faqen e komunës. Komuna e Dibrës në mënyrë participative me konsultimin e organizatave qytetare dhe palët e tjera të prekura do të caktojë fushat ku mund të delegohen kompetencat. Në mënyrë plotësuese do të ndërmerren masat administrative që komuna të mund një pjesë të kompetencave të veta, të cilat do të vendos ti delegojë, të zbatohen nga ana e organizatave qytetare.

## 3.4. Mekanizëm i vendosur për mbështetje (financiare) të iniciativa të përbashkëta të komunës dhe OQ

Komuna e Dibrës është e vetëdijshme për nevojën nga mbështetja financiare e organizatave lokale në kushte të donacioneve të zvogëluara nga burimet tjera nga vendi dhe jashtë. Prandaj gjatë viteve të kaluara komuna në masë të madhe e ka mbështetur sektorin civil me mjetet nga buxheti i komunës. Komuna e Dibrës ndan përqindje më të madhe të mjeteve nga buxheti i vet për financimin e projekteve të organizatave qytetare në krahasim me njësitë tjera të vetëqeverisje lokale në vend. Këtë trend komuna do ta mbajë edhe në të ardhmen, veçanërisht me vendosjen e procedurave më transparente dhe kriterëve për ndarjen e mjeteve dhe me shpalljen e rregullt të thirrjes publike, me çka do të forcohet besimi mes organizatave qytetare dhe pushtetit lokal si parakusht për ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe të fuqishme.

Që të arrihet ky qëllim komuna do të angazhohet për:

- 1) Mbështetje e rregullt financiare e projekteve të organizatave qytetare (financimi dhje ko-financimi) nga buxheti i komunës;
- 2) Definimi i procedurës dhe kriterëve transparente për mbështetje financiare të organizatave qytetare;
- 3) Praktikizmi i thirrjes publike për financimin e projekteve të organizatave qytetare.

Mbështetja financiare e Komunës së Dibrës ndaj organizatave qytetare do të jetë e hapur dhe publike. Për këtë qëllim do të përpunohet formular standard për paraqitje, ndërsa thirrjet do të publikohen rregullisht dhe do të kenë qasje të gjitha organizatat e interesuara qytetare. Komuna çdo vit do ti caktojë fushat prioritare në të cilat do të financohen projektet e organizatave qytetare në formë të programit vjetor për financim. Procedura dhe kriteret për mbështetje financiare të organizatave qytetare do të jetë transparente. Komuna e Dibrës gjatë financimit të organizatave qytetare do ti aplikojë dispozitat nga Kodeksi i qeverisë për praktikat më të mira të financimit të shoqatave dhe fondacioneve nga ana e buxhetit. Organizatat qytetare do të përgatisin raporte për projektet e (ko)financuara nga buxheti i komunës, derisa komuna në fund të vitit do të

përgatisë raport për mjetet të cilat i ka ndarë dhe për shfrytëzimin e tyre. Për sigurimin e zhvillimit të papenguar të aktiviteteve të organizatave qytetare, Komuna Dibrës do të caktojë edhe fond të veçantë në buxhetin e komunës për ko-financimin e projekteve për të cilat organizatat qytetare kanë fituar mbështetje nga donatorët tjerë (si për shembull mbështetja e IPA e BE, komponenti për bashkëpunim ndërkuftar etj.).

## 3.5. Avancimi i rolit të OQ dhe vullnetarizmi në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës

Komuna e Dibrës duke e njohur rolin e rëndësishëm të vullnetarizmit si vlerë për shoqërinë, bashkë me organizatat qytetare do të përpiqet të promovojë dhe të nxisë aksione vullnetare dhe në përgjithësi aktivizmin qytetar. Gjithashtu, komuna do të angazhohet për rritjen e numrit të organizatave qytetare të cilat mes tjerash do të kontribuojnë drejt edukimit të popullatës dhe motivimin për inkuadrimin e tyre më të madh në aktivitetet. Angazhimi i vazhdueshëm dhe puna drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta specifike mes tre sektorëve do të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm. Biznese lokale me përgjegjësi shoqërore do të nxiten ta ndihmojnë zhvillimin e Komunës së Dibrës, por nevojitet të motivohen, si nga ana e organizatave qytetare, ashtu edhe nga komuna. Praktikrat me përgjegjësi shoqërore të bizneseve lokale, ndikimi i të cilave mbi shoqërinë dhe mjedisin jetësor është me rëndësi të madhe, do të kontribuojnë për përmirësimin e kualitetit të përgjithshëm të jetës në Komunën e Dibrës.

Që të arrihet ky qëllim komuna do të angazhohet për:

- 1) Vendosja e inkubatorit të OQ;
- 2) Ti mbështesë me mjete financiare projektet e OQ, të cilat promovojnë vullnetarizëm dhe aktivizëm qytetar;
- 3) Inicimin e konkurseve për vullnetarizëm/punë praktike në komunë dhe institucionet publike;
- 4) Promovimin e përgjegjësi shoqërore të bizneseve lokale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës;
- 5) Zbatimin e aktiviteteve promovuese dhe nxitëse për aktivizëm qytetar dhe vullnetarizëm.

Vendosja e inkubatorit të organizatave qytetare, i cili do të gjenerojë organizata të reja do të mbështetet nga komuna, ndërsa në bashkëpunim me sektorin privat. Komuna do të sigurojë kushte minimale logjistike për funksionimin e inkubatorit dhe do të ndërmerë më shumë aktivitete që ti nxitë bizneset lokale që ta shohin rëndësinë e sektorit të zhvilluar civil, e me këtë edhe ta mbështetin qëndrueshmërinë e organizatave

të porsaformuara. Rëndësia e vullnetarizmit do të theksohet me prioritetimin e tij në programin e komunës për financimin e organizatave qytetare, ndërsa komuna rregullisht çdo vjet do të mbështesë organizata të cilat promovojnë vullnetarizëm dhe aktivitete me aktivizëm masovik qytetar. Vetë komuna në përpjekjet e saja ta mbështesë vullnetarizmin do të definojë se cilët sektorë nga administrata e vet ka nevojë për vullnetarë dhe praktikantë, do ta analizojë interesimin e të rinjve dhe studentëve të papunësuar për punë, që ekziston në kuadër të komunës dhe në mënyrë adekuate do ti angazhojë me caktimin e mentorit, i cili do ti udhëheqë në procesin e punës së komunës. Aktivitete promovuese për nxitjen e vullnetarizmit dhe aktivizmit qytetar do të jenë: materialet e shtypura, ngjarje të caktuara, aksione të përbashkëta, mbështetja e aksioneve lokale me përpjekje të përbashkëta, shënimi i ditës së vullnetarizmit, ndarja e çmimeve për kontributin vullnetar etj.

# IV. ZBATIMI, PËRCJELLJA DHE REVIZIONI

Komuna dhe organizatat qytetare në mënyrë primare janë përgjegjëse për përcjelljen e procesit të zbatimit të Strategjisë, si dhe efektiviteti i saj, me qëllim që të përshtaten aktivitetet me nevojat aktuale.

Personi përgjegjës për bashkëpunim me organizatat qytetare, i udhëhequr nga Komiteti drejtues dhe në konsultime me organizatat qytetare do të përgatisë plan për përcjellje të zbatimit të Strategjisë.

Plani do të parashihet që personi përgjegjës dhe Komiteti drejtues të dorëzojë raport në fund të çdo viti deri te Këshilli i Komunës së Dibrës për aktivitete e kryera dhe qëllimet e arritura nga zbatim i Strategjisë. Pas vitit të dytë nga zbatimi i Strategjisë do të bëhet vlerësimi i arritjeve të Strategjisë. Vlerësimi do të përgatitet përmes konsultimeve me përfaqësuesit e organizatave qytetare, komunës, biznes sektorit, qytetarëve dhe mediave. Do të kërkohet mbështetje e jashtme për facilitimin e procesit të vlerësimit të Strategjisë. Rezultatet nga vlerësimi do të përmbajnë analizë të zbatimit të deriatëhershëm, informata për qëllimet e arritura, përfundime dhe rekomandime për ndryshimet e mundshme dhe përshtatjen e Strategjisë dhe Planit aksionar drejt gjendjes dhe nevojave.

Komiteti drejtues dhe personi përgjegjës për bashkëpunim me organizatat qytetare e kanë rolin primar në koordinimin e zbatimit të Strategjisë.

Aktivitetet konkrete për zbatimin e Strategjisë me kornizë zë caktuar kohore, bartësit e aktiviteteve, gjegjësisht institucionet përgjegjëse, treguesit për aktivitetet e realizuara dhe caktimi i burimit të financimit të aktiviteteve janë përmbajtur në Planin aksionar, që është pjesë përbërëse e kësaj strategjie (Shtojca 1).

# SHTOJCA 1. PLANI AKSIONAR



Mekanizëm i vendosur i bashkëpunimit mes Komunitetit të Dibrës dhe organizatave qytetare dhe grupeve të qytetarëve						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
1.1	Personi i caktuar me kompetenca të qarta nga komuna për bashkëpunim me OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Definimi i përkrahimit të kompetencave për personin e caktuar për komunikim me OQ;</li> <li>▶ Zgjedhja e personit përgjegjës për bashkëpunim me OQ;</li> <li>▶ Rregullat e vendosura të informimit dhe komunikimit mes personit përgjegjës dhe organizatave (mbledhje të rregullta, përgatitja e buletineve informativ, shkëmbimi i informatave etj.).</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Person i zgjedhur për bashkëpunim me OQ</li> <li>▶ Numri i mbledhjeve të mbajtura mes OQ dhe personit të caktuar për bashkëpunim i VL</li> <li>▶ Numri i informatave të dërguara deri te OQ (e-mail)</li> </ul>	Buxheti i VL
1.2	Është themeluar Komiteti drejtues për përcjelljen e bashkëpunimit mes komunitetit të Dibrës dhe për vëzhgimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë (përfasësues të OQ, vetëqeverisja lokale)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Definimi i kriterëve për seleksionimin e përfaqësuesve në Komitetin drejtues (duke përfshirë edhe mandatin dhe përbërjen);</li> <li>▶ Zgjedhja e anëtarëve të komitetit (nga ana e Këshillit);</li> <li>▶ Mbajtja e mbledhjeve të komitetit;</li> <li>▶ Përgatitja e programit vjetor në pajtim me strategjinë;</li> <li>▶ Mbajtja e mbledhjeve me fokus grupe për përgatitjen e raportit për progresin e zbatimit të strategjisë;</li> <li>▶ Raporte vjetore për zbatimin e strategjisë.</li> </ul>	VL OQ	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Komiteti drejtues është themeluar (KD)</li> <li>▶ Numri i mbledhjeve të KD</li> <li>▶ 4 programe vjetore</li> <li>▶ Numri i mbledhjeve me fokus grupe</li> <li>▶ 4 raporte vjetore</li> </ul>	Buxheti i VL

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
1.3	<p>Është siguruar hapësirë në ueb faqen e komunës për organizatat qytetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Sigurimi i të dhënave nga RQM për organizatat e regjistruara në komunë;</li> <li>▶ Shpallja e thirrjes për regjistrim në bazën e të dhënave të komunës deri te OQ e regjistruara në komunë;</li> <li>▶ Caktimi i nëpunësit përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës;</li> <li>▶ Zgjidhje softueri për bazën e të dhënave;</li> <li>▶ Vendosja e bazës të dhënave në ueb faqen e komunës;</li> <li>▶ Azhurnimi i rregullt i të dhënave;</li> <li>▶ Sigurimi i hapësirës për vendosjen e informatave aktuale nga OQ;</li> <li>▶ Dërgimi dhe publikimi i rregullt i informatave nga OQ (raportet vjetore për punë, lajmërimi për aktivitetet, rezultatet, ngjarjet, etj.).</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Baza e të dhënave e përgatitur</li> <li>▶ Numri i organizatave të regjistruara në bazë</li> <li>▶ Ueb faqja e adaptuar</li> <li>▶ Numri i informatave të shpallura nga OQ në ueb faqen e komunës</li> </ul>	Buxheti i VL/ donatorë
1.4	<p>Kapacitete të zhvilluara të personit përgjegjës për bashkëpunim me sektorin civil dhe nëpunësit relevant nga administrata komunale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Vlerësimi i shkathësive, njohurive dhe kapaciteteve të nëpunësit përgjegjës për bashkëpunim dhe administratës komunale;</li> <li>▶ Përgatitja dhe zbatimi i planit për zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësit përgjegjës dhe nëpunëve tjerë relevant në administratën komunale.</li> </ul>	VL	2012-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Plani i miratuar për zhvillimin e kapaciteteve</li> <li>▶ Numri i trajnimeve të vizituara</li> <li>▶ Numri i vizitave të studimit/shkëmbimi i përvojave</li> <li>▶ Raporte për aktivitetet e realizuara (Trajtime, vizita studimi etj.)</li> </ul>	Buxheti i VL/ donatorë

Rritja e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në proceset e planifikimit dhe zbatimit të politikave lokale						
Q5 2	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
2.1	Janë integruar parimet e pjesëmarrjes në rregulloren e pushtetit lokal (statuti, vendimet e Këshillit të komunës, rregulloret)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Plotësimi i statutit të komunës me parimet për bashkëpunim aktiv me sektorin civil;</li> <li>▶ Përgatitja e rregullores për inkuadrimin e sektorit civil në proceset e planifikimit dhe zbatimit në fushat me interes publik.</li> </ul>	VL	2012	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Statuti i ndryshuar</li> <li>▶ Rregullore e përgatitur</li> </ul>	Buxheti i VL
2.2	OQ janë motivuar që të inkuadrohen në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve strategjike në fusha të caktuara (mjedisi jetësor, çështjet sociale, kultura, sporti, të rinjtë, arsimi, zhvillimi ekonomik etj.).	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Përpunimi i planit për inkuadrin të OQ në përgatitjen e dokumenteve strategjike (Propozime me shkrim nga ana e qytetarëve, diskutime publike);</li> <li>▶ Formimi i grupit të punës të përzier për përgatitjen të procedurës dhe kriterëve për zgjedhje të përfundimit të OQ;</li> <li>▶ Praktikizmi i procedurës së vendosur dhe kriterëve për zgjedhje të përfundimit të OQ.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Plani i miratuar për inkuadrin e përfundimit të OQ</li> <li>▶ Numri i OQ të inkuadruar në përgatitjen e dokumenteve strategjike në fusha të ndryshme</li> <li>▶ Numri i diskutimeve nga ana e OQ</li> <li>▶ Numri i propozimeve të pranuar nga OQ</li> </ul>	Buxheti i VL

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
2.3	Përfaqësues të OQ marrin pjesë në trupat/komisionet punuese të pushtetit lokal	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemi i vendosur (procedurë de kritere) për seleksionimin e përfaqësuesve të OQ për pjesëmarrje në komisione;</li> <li>Inkuadrimi i përfaqësuesit nga ana OQ në pajtim me temën për diskutim të komisionit;</li> <li>Komunikimi i rregullt dhe konsultimet mes Komitetit drejtues për përcjellje të zbatimit të strategjisë dhe Komisionit për marrëdhënies mes bashkësive.</li> </ul>	LV OQ	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i komisioneve ku është inkuadruar përfaqësues i OQ (lidhur me të gjitha komisionet e mbajtura)</li> <li>Numri i mbledhjeve dhe informatave të shkëmbyera mes KD dhe KMMB</li> </ul>	Buxheti i VL
2.4	Prakticizmi i modelit "Forumet në bashkësi" si mënyrë e inkuadrimit të OQ dhe qytetarëve në proceset e krijimit të politikave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbajtja e ngjarjeve të rregullta konsultative për zgjedhje të projekteve prioritare;</li> <li>Caktimi i mjeteve në buxhetin për Forumet në bashkësi për një projekt.</li> </ul>	VL	2012-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i forumeve të realizuara</li> <li>Numri i qytetarëve/OQ të inkuadruar në Forum</li> <li>Numri i projekteve të realizuara nga Forumi</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë
<b>Q5 3 Zhvillimi i partneriteteve strategjike mes komunës dhe organizatave qytetare</b>						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
3.1	Janë analizuar dhe përcaktuar fushat specifike me interes të bashkësisë lokale për iniciimin e partneritete me OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i procesit konsultativ me OQ gjatë përcaktimit të fushave specifike me interes të bashkësisë lokale;</li> <li>Caktimi dhe promovimi i fushave specifike me interes të komunës për iniciimin e partneritetit me OQ.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i takimeve të mbajtura konsultative</li> <li>Numri i OQ të inkuadruar në konsultime</li> <li>Fushat e caktuara</li> <li>Ngjarjet e organizuara dhe lloje tjera të shpalljeve (p.sh. në ueb faqe) për promovimin e fushave</li> </ul>	Buxheti i VL

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
3.2	Mekanizimi i vendosur për koordinim gjatë financimeve të mundshme të aktiviteteve nga fushat e caktuara me interes për bashkësinë lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Organizimi i ngjarjeve informative për thirrjet e hapura;</li> <li>▶ Publikimi i informatave të kapshme për thirrjet në ueb faqen e komunës;</li> <li>▶ Konsultime të rregullta dhe mbledhje koordinative për partneritetet potenciale (gjatë aplikimit);</li> <li>▶ Përgatitja e aplikacioneve të përbashkëta;</li> <li>▶ Nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim.</li> </ul>	VL	2012-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Numri i ngjarjeve të mbajtura informative</li> <li>▶ Numri i shpalljeve informative në ueb faqen</li> <li>▶ Numri i mbledhjeve për partneritetet potenciale</li> <li>▶ Numri i aplikacioneve të përbashkëta</li> <li>▶ Numri i memorandumeve të nënshkruara</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë
3.3	Janë caktuar mekanizmat për delegimin e kompetencave nga ana e komunës të OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Caktimi i fushave në të cilat mund të delegohen kompetencat;</li> <li>▶ Zhvillimi i kriterëve për delegimin e kompetencave;</li> <li>▶ Praktika e vendosur për delegimin e kompetencave.</li> </ul>	VL OQ	2014-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Janë caktuar fushat për delegimin e kompetencave</li> <li>▶ Janë miratuar kriteret për delegimin e kompetencave</li> <li>▶ Numri i kompetencave të cilat janë deleguar te OQ</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë
<b>QS 4</b>	<b>Mekanizimi i vendosur për mbështetje (financiare) të projekteve të organizatave qytetare</b>					
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
4.1	Mbështetje rregullt e projekteve të OQ (financimi dhe ko-financimi) nga buxheti i komunës	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Caktimi i mjeteve në buxhetin e komunës për mbështetje të projekteve të OQ;</li> <li>▶ Caktimi i fondit të veçantë nga buxheti i komunës i dedikuar për ko-financimin e projekteve.</li> </ul>	VL	2012	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Shuma e mjeteve të caktuara për mbështetje të OQ (% nga buxheti)</li> <li>▶ Lartësia e caktuar e fondit të veçantë për ko-financim</li> <li>▶ Trend i rritjes së shumës në pikën buxhetore për mbështetje të OQ</li> </ul>	Buxheti i VL

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
4.2	Është definuar procedura e mjeteve financiare për OQ; dhe kriteret për mbështetje financiare të OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përgatitja e kriterëve dhe procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për OQ;</li> <li>Vendosja e praktikës që OQ të raportojnë për projektet e (ko)financuara nga buxheti i komunës;</li> <li>Përgatitja e raportit vjetor nga ana e komunës për mjetet e ndara dhe shpallja e tij publike.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kritere dhe procedura e miratuar</li> <li>Raporte përfundimtare nga OQ për projektet e mbështetura</li> <li>Raporte vjetore të komunës për mjetet e ndara</li> </ul>	Buxheti i VL
4.3	Prakticizmi i thirrjeve publike për financimin e projekteve të OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpunimi i formularit për aplikacion;</li> <li>Shpallja e rregullt e thirrjes publike.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Formularë të përgatitur për aplikim</li> <li>Numri i thirrjeve publike të shpallura</li> <li>Numri i OQ të cilat kanë fituar mjete</li> </ul>	Buxheti i VL
<b>QS 5 Avancimi i rolit të OQ dhe vullnetarizimit në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës</b>						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
5.1	Themelimi i inkubatorit të OQ	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëpunimi i komunës me sektorin privat për ko-financim (të mundshëm) të inkubatorit për OQ.</li> </ul>	VL OQ	2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kriteret për shfrytëzimin e inkubatorit të OQ</li> <li>Inkubatori i themeluar</li> </ul>	NJVL Sektori privat Donatorë
5.2	Financiarisht mbështeten projektet e OQ nga ana e komunës, të cilat promovojnë vullnetarizim dhe aktivizim qytetar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i vullnetarizimit si prioritet themelor në programin e komunës për financimin e OQ;</li> <li>Aplikohet mbështetja e rregullt vjetore financiare e OQ të cilat promovojnë vullnetarizim;</li> <li>Mbështetje financiare e OQ të cilat promovojnë aktivitetet me inkadrim masovik të qytetarëve.</li> </ul>	VL	2012-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i projekteve të mbështetura për vullnetarizim</li> <li>Shuma e mjeteve të ndara për promovimin e vullnetarizimit</li> <li>Numri i anëtarëve së rritur në OQ</li> <li>Numri i ngjarjeve për promovimin e vullnetarizimit dhe inkadrim masovik i qytetarëve</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjete financiare
5.4	Janë iniciuar konkurse për vullnetarizëm/punë praktike në komunë dhe institucionet publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Definimi i sektorëve në komunë, të cilat kanë nevojë për praktikantë;</li> <li>▶ Analiza mes të rinjve dhe studentëve të papunësuar për interesimin e tyre për unë praktike dhe fushat për punë praktike;</li> <li>▶ Caktimi i mentorëve për praktikantët dhe udhëheqja e praktikantëve në procesin e punës në administratën lokale.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Anketa e zbatuar për interesimin për punë praktike/vullnetarizëm</li> <li>▶ Numri i praktikantëve/vullnetarëve në sektorin publik</li> </ul>	Buxheti i VL
5.5	Promovohet përgjegjësia shoqërore e bizneseve lokale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Caktimi i prioriteve nga komuna për mbështetje të projekteve nga ana e bizneseve lokale;</li> <li>▶ Organizimi i forumeve për shkëmbim të informatave për bashkëpunim potencial mes komunës, OQ dhe bizneseve lokale.</li> </ul>	VL	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Prioritete të caktuara në komunë</li> <li>▶ Numri i ngjarjeve promovuese (forumeve)</li> <li>▶ Numri i OQ prezent dhe bizneseve lokale</li> <li>▶ Numri i projekteve të mbështetura të OQ nga ana e bizneseve lokale</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë
5.5	Zbatohen aktivitetet promovuese dhe nxitëse për aktivizëm qytetar dhe vullnetarizëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Shtypi i materialit promovues për vullnetarizëm dhe aktivizëm qytetar;</li> <li>▶ Organizimi i aksioneve vullnetare lokale;</li> <li>▶ Shënimi i ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit (mirënjohje për shoqatën më të mirë, aktivistin më të mirë, mbështetësin më të mirë nga ana e bizneseve lokale, etj.);</li> <li>▶ Organizimi i përbashkët i ngjarjeve për mbështetje të aksioneve lokale (ekologji, arsim, kulturë, etj.).</li> </ul>	VL OQ	2012-2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Numri i materialeve të shtypura</li> <li>▶ Numri i ngjarjeve të organizuara</li> <li>▶ Numri i aksioneve të përbashkëta</li> <li>▶ Numri i pjesëmarrësve në akstionet vullnetare lokale</li> </ul>	Buxheti i VL / donatorë

